

Shkodra- vendtakim qyteterimesh !

Gjurmët e para fillojnë rreth 2500 vjet me pare



Qyteti zhvillohet në kodrinë e kalasë Rozafa e cila ndodhet 130 meter mbi nivelin e detit



Jeta qytetare ze fill aty nga shek IV p.k. dhe lidhet me lindjen e qytetit antic te Shkodres. (Scodra, Scobre etj). Ne vitet 181-168 p.k Shkodra behet qendra e e mbretit te fundit ilir Gent. Kalaja ishte rezidenca e tij dhe kryeqender e nje sistemi fortifikues qe qarkonte pellgun e Shkodres. Sipas biografit te perandorit Justinian, Prokopi i Cezarese , shkruan se Keshtjella eshte rindertuar ne kete kohe pra rreth viteve 527-565.

Te dhenat per historine e qytetit gjate periudhes se mesjetes se hershme shek 6-11 pas kr, jane mjaft te zbehta.



Rreth vitit 1355 klasa feudale shqiptare shfaqet si force politike e pavarur , duke organizuar edhe 3 principatat feudale. Ne kete kuader historik shfaqet familja feudale e balshajve e cila krijon principaten e saj me kryeqender Shkodren.

Qyteti i Shkodres i beri balle dy rrethimeve osmane te vitit 1474-1478, por ne vitin 1479 qyteti do te kalonte nen sundimin osman.Kalaja e Shkodres ka qene qender administrative e qytetit deri ne vitin 1865 .

Me 1360 kryeqender e principates te Balshajve ku kalojme nen pushtimin e Venedikasve dhe qyteti merr emrin SKUTARI.

Statutet e Shkodres



Momenti qe qyteti yne Shkodra, ndahet nga shume qytete te tjera eshte pa asnje dyshim ekzistenca e “ Statuteve te Shkodres” Serioziteti i këtyre statuteve duket që në fjalitë e para të tij ku thuhet se "*Asnjë njeri, qoftë qytetar i Shkodrës, apo i huaj, nuk është i justifikuar nëse injoron "Urdhërat e Statutit".*

Madje, sipas Lucia Nadin, gjetja e "Statuteve të Shkodrës" rihap një faqe shumë të rëndësishme, të harruar, të historisë së këtij vendi, i njohur vetëm si "*vendi i shqiponjave*". Kjo e bën atë të qëndrojë më së miri në krah të çdo vendi tjetër të zonës së Adriatikut.

Eshtë vërtetë 'Një monument i vërtetë i Shqipërisë Mesjetare'", shprehet studiuesi, Oliver Jens Schmitt, madje studiuesi tjetër Gherardo Ortalli mendon se është diçka më shumë,

pasi ka rëndësi të madhe historike për pjesën lindore të Adriatikut dhe raportet e saj me Venecian, që me potencën e saj të madhe arriti të ruante ekuilibrat ndërkombëtarë




Shekulli i XVIII është me i madhi në historinë e qytetit që ka ngritur prej vitit 1718 agjensitë e para konsullorë dhe me 1730 krijon dhomen e tregëtisë. Duket sikur Shkodra për një kohë bie në hije, por atë e ngjall familja e madhe vendase e Bushatlinjve, ku që me 1787 Mahmut pashe Bushtliu tentoi për një principatë të pavarur shqiptare.

Deshmimetare të lavdisë së hershme janë monumentet historike-kulturore

URA E MESIT

. Është e ngritur mbi Lumin Kir, dhe lidh këto zone me zonën prealpine të Shales, Shoshit etj. Ura është kryevepër e mjeshtrave shqiptarë, kryesisht ustallare dibrane të cilet me urdher të Mehmet pashe Plakut ndertuan këtë urë në vitin 1768.

Ura eshte rreth 112 m e gjate, dhe eshte ura me e gjate ne Shqiperi e ndertuar me gure, gjeresia e saj eshte 3.5m dhe lartesia e saj 15m. Ura ka 13 harqe



XHAMIA E PLUMBIT

E vetmja perfaqesuese e tipit klasik otoman . E themeluar nga Mehmet Pashe Bushati ne itin 1773-1774. Xhamia perbehet nga salla e lutjeve me mihrabin , dy portike ne anen veriore e jugore te saj dhe portiku oborr i saj i mbyllur ne anen perendimore. Volumin qendror te kompozimit e perbensalla e lutjeve me nje planimetri katrore me permasa 9.17 me 9.17m Zgjidhja e jashteme e godines eshte e arritur ndonse trajtimi i mureve eshte monokromatik. Nje vend te rendesishem ze kupola mbi tamburin e larte , element qendror i teresise per nga permasat si nga ana arkitektonike ashtu edhe nga ana funksionale.

Aktualisht eshte objekt Monument kulture i Kategorise se pare.



KATEDRALJA E SHEN STEFANIT NE KALA TE SHKODRES


Eshte nje nga ndertimet me me vlere te Shkodres mesjetare dhe ndodhet prane mureve rrethuese ne anen veriperendimore te Kalase. Ajo perbehet nga naosi mjedisi i altarit dhe hajati ne anen jugore. Ne kete kend ne anen e jashteme ne vitin 1479 ndertohet minarja dhe fillon funksionin si xhami ne brendesi te kalase.

Nga ana arkitekturore katedralja e Shen Shtjefnit peraqitet me te gjitha karakteristikat e shkolles se Veriut , qe i takojne arkitektures romanike-gotike. Ajo shquhet per ndertim rigoroz e te paster te muratures se faqeve te jashteme , per vellim unik te brendesise, per hedhjen vertikale te naosit dhe mjedisit te altarit per qemeret e brinjezuar e harqet e mprehte per arkadet e hajatit.




PAZARI I VJETER I SHKODRES

Pazari i vjeter i Shkodres, permendet qysh ne Statutet e Shkodres, me emrin –favolete-. Pazar i Vjeter i Shkodres shtrihej nga ana verilindore e keshtjelles , ne rafshinen ndermjet kodrave te Tepes e Lumit Buna. I vendosur prane qytetit te vjeter dhe e i lidhur organikisht me skelen lumore. Ai luajti nje rol te rendesishem zejtar-tregetar deri ne vitet 70 te shekullit te XIX ku arriti ne 2500 njesi prodhimi e tregetimi. Pazar i ishte i ndertuar me vargje paralele te rrugeve , me skema te improvizuara , mbyllur me rreshtime dyqanesh te perngjitur njeri me tjetrin. Kompleksi me i madh i ketij Pazar i ishte Bexhisteni i vendosur ne qender te tij i ngritur nga veziri i shkodres Ibrahim pashe Bushati gjate viteve 1807-1808. Bexhisteni ishte nje Pazar i mbyllur me 64 dyqane dykateshe ku tregetoheshin mallra me vlera te medha ku xhiroja tregetare arriti ne 8.4 milion franga ari.



NDERTESA E ISH –PREFEKTURES (sot Bashkia Shkoder)

Ndertesa shquhet per pamjen e saj madheshtore, por edhe unikale, sepse i vetmi pallat i ndertuar me kete stil ne Shqiperi. Ndertimi i saj , u realizua sipas projektit te A.Briot , kryeinxhinjerit me origjine franceze prane guvernatures se Shkodres, dhe jetoj deri pas pavaresise.Ndertimi filloi ne vitin 1910 dhe perfundoi ne vitin 1912 kur filloi Lufta Ballkanike.



KAFE E MADHE (KAFE PARK)

Kafja eshte pjese e atij kompleksi ndertimesh qe mbushin rrugen e pjaces te projektuara edhe ato nga Idromeno.. Verehet nje gershetim i tradites se ndertimit te godinave qytetare me stile te ndryshme , vecanerisht te fasadave , dekoracioneve, korniza, bordura, mensola, ballkone te stisura dhe dritare me grila.Eshte i dukshem ne kete drejtim , ndikimi i arkitektures se qyteteve te perparuara te mesdheut.

Kaja e Madhe ishte ne ato vite shprehja tipike e zhvillimit te kapitalizmit ne fushen e tregetise dhe vecanesht ne ate te hotelerise



BANESA KARAKTERISTIKE SHKODRANE

Banesa qytetare shkodrane e tipit "me çardak", përbën një nga realizimet arkitekturore më të përkryera në tipologjinë e banesës tradicionale shqiptare. Shkodra bazohej kryesisht në ekonominë tregtare, por edhe në aktivitete të tjera ekonomike si artizanati, kopshtaria, blegtoaria, peshkimi etj. Ky tip shtëpie ka një arkitekturë të stilit oriental. Nuk shërbente vetëm si banesë për familjen por edhe vend pune, veçanërisht për gratë, që përgjithësisht bënin një jetë të mbyllur sociale gjatë kësaj periudhe deri në fillim të shek. XX kur pamja urbanistike e arkitekturore e qytetit merr tiparet e një qyteti perëndimor, me shtëpi dy-tre katesh të ngjitura me njëra tjetrën në dy anët e rrugës, me dyqane poshtë me fasada guri të dekoruara, sikurse është rruga e "Piacës".




SAHATI I INGLIZIT

Nje nder tiparet e qyteteve tona kryesore ishte edhe prania e Kullave te Sahatit. Shtepia me gure te gdhendur si edhe Kulla e Sahatit jane ndertuar me fonde te nje aristokrati anglez rreth cerekut te fundit te shekullit te XIX. Ndertesa te jep pershtypjen e nje keshtjelle mesjetare , por me permasa shume te vogla. E ndertur nga Lordi Paget qe kish ardhur ne Shkoder per te perhapur fene protestane. Ne shtepine qe ndertoi lordi , sallonin e madh e pershtati ne stilin oriental , me tavane te daltuar, me trapazane dhe ndarje te tjera. Thuhet se lordi ia dhuroi shtepine nje oficeri anglez prane qeverise se Zogut i cili ne vitin 1930 ua shiti dy tregetareve vendas per 40 mije franga. Shtepia ka 15 dhoma , oborri ka pasur nje dere te madhe me dekoracione dhe mbi te te gdhendur stemen e Anglise.



Shkodra e legjendave, Shkodra e Vargjeve te lira dhe shkrimit, Shkodra e Bibliotekave ku deri ne vitin 1944 numeroheshin 28 biblioteka te rendesishme me karakter albanologjik, Shkodra e fotografise dhe historise nepermjet saj duke filluar me Marubin, Shkodra e Piktures Realiste themelues i se ciles Kol Idromeno, Ndoc Martini, Simon Rrota, Kel Kodheli, Zef Kolombi, Ismail Lulani etj





Shkodra vendtakim qyteterimesh !

Shkodra , toka e te mbijetuarve . Historia e qytetit te rrethon ngado qe te kthehesh , je gjithë kohes i kapur nga pelhura e padukshme e endur nga artiste e xhahile, njerez te ditur dhe te pagdhendur, shenjtoze dhe vrases, te kulturuar dhe barabare.Pelhure qe mbeshtjell gjithë qytetin dhe qe sa me shume perpiqesh ti shpetosh aq me shume e gjen veten te mberthyer prej saj.

Edit'h Durham

Sidoqofte per nje pike une kam te njejten ndjenje te perbashket me shqiptarin, Shkodra me mrekullon. Kur nuk jam atje, po ja u rikujtoj, qe vetem atehere, jam thuar gati te betohem bashke me shqiptarin se ajo eshte qyteti me i mire ne bote.....

E mbas kesaj ne Ju themi:

Miresevini ne Shkoder!

Shkodra vendtakim qyteterimesh...